



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

### DREJTORIJA E INSPEKTORATIT

<b>Datë :</b>	<b>03.04.2017</b>
<b>Referencë</b>	<b>11-344/3</b>
<b>Për :</b>	<b>Kryetar i Komunes-z. Imri Ahmeti</b>
<b>Përmes :</b>	<b>Drejtpërsëdrejti</b>
<b>Nga :</b>	<b>Drejtori i Drejtorisë të Inspektoratit - z. Imer Rrustemi</b>
<b>Lënda :</b>	<b>RAPORTI MUJOR-MARS</b>

## Pasqyra tabelare e punës për muajin –MARS

Inspektorët	Gjithsej	Inspektime me procesverbal	Pranime teknike	Fletëparaqitje për kundërvajtje	Inspektime për pirjen e duhanit	Vërejtje, njoftime	Mbyllje e përkohëshme	Lëndë e ekzekutuara gjyqësore	Inspektime të përbashkëta	Pëlqime sanitare	Vendosje e shiritav zyrtar	Inspektim i auto-taxi	Menaxhim i tregjeve	Aktvendime- ndalesa, urdhëresa	Kërkesa, pune me palë	Gjoha mandatore	Inspektim i kafshëve në thertore	Inspektime me polici	Inspektim i tokave bujqësore	Biznese të paregjistruara dhe pa pranime teknike	Mallë me afat të skaduar
<b>Biznesit</b>	<b>734</b>	<b>59</b>	<b>32</b>			<b>117</b>	<b>19</b>	<b>1</b>	<b>113</b>				<b>10</b>	<b>123</b>	<b>195</b>			<b>16</b>		<b>59</b>	
<b>Ambientit</b>	<b>363</b>	<b>31</b>		<b>2</b>		<b>6</b>			<b>132</b>						<b>181</b>	<b>2</b>		<b>9</b>			
<b>Bujqësisë</b>	<b>290</b>	<b>16</b>				<b>55</b>			<b>58</b>						<b>112</b>				<b>49</b>		
<b>Ndërtimtarisë</b>	<b>24</b>	<b>12</b>							<b>11</b>		<b>1</b>										
<b>Trafikut</b>	<b>396</b>	<b>26</b>				<b>89</b>			<b>55</b>			<b>101</b>	<b>8</b>		<b>46</b>			<b>71</b>			
<b>Sanitar</b>	<b>286</b>	<b>31</b>		<b>4</b>	<b>67</b>	<b>28</b>		<b>8</b>	<b>91</b>	<b>5</b>					<b>31</b>		<b>21</b>				<b>56.25€</b>
<b>Gjithsejtë</b>	<b>2093</b>	<b>175</b>	<b>32</b>	<b>6</b>	<b>67</b>	<b>295</b>	<b>9</b>	<b>9</b>	<b>460</b>	<b>5</b>	<b>1</b>	<b>101</b>	<b>18</b>	<b>123</b>	<b>565</b>	<b>2</b>	<b>21</b>	<b>96</b>	<b>49</b>	<b>59</b>	<b>56.25€</b>

Gjatë muajit Mars kemi hasur në 35 biznese të pa regjistruara në qendrën e regjistrimit të biznesit ku janë urdhëruar me procesverbal dhe me aktvendim që të bëjnë regjistrimin e tyre pranë qendresë së regjistrimit të bizneseve ARBK-së, Lipjan.

Gjithashtu kemi pasur 24 biznese pa pranime teknik te lokaleve afariste për plotësimin e kushteve tekniko higjienike ku janë urdhëruar me procesverbal dhe aktvendim që të aplikojnë pranë Drejtorisë së Inspektoratit tek inspektorët e tregut.

Kemi pasur një aksion së bashku me Inspektorët e ATK-së departamenti i lojnavë të fatit, dhe oficeret Doganor janë konfiskuar pajisje teknologjike të lojnavë keno, lojnavë me qenë si dhe lojna lucky balls, në disa fshatra te komunës së Lipjanit dhe janë mbyllur 4 bastore sportive ku nuk kanë qenë të regjistruara dhe nuk kanë pasur pëlqim nga inspektorët e tregut për të ushtruar aktivitetin biznesor

Po ashtu kemi pasur disa aksione së bashku me Policin e Kosovës Departamenti NJHTQNJ, dhe Policin e stacionit Policor në Lipjan ku kemi inspektuar disa subjekte të ndryshme ekonomike, si ato me veprimtari të rekreacionit, bilardo, kafe të natës, internet kafe, restorante, etj. Gjatë këtij aksioni janë mbyllur 5 subjekte ekonomike të cilat nuk kanë qenë të regjistruar ne MTI Prishtinë njësia në Lipjan, si edhe nuk kanë pasur pëlqim nga inspektorët e tregut për ta ushtruar këtë aktivitet ekonomik.

Gjatë inspektimit në disa markete është gjetur mall me afat të skaduar në vlerë prej 56.25€ i cili është asgjësuar në vend.

Në bazë të urdhëresës së dhënë nga kryeinspektori Sanitar i Kosovës për të larguar një produkt të “Hipp Rice Pudding” janë inspektuar të gjitha barnatoret humane si dhe marketet por produkti i tillë nuk është gjetur në treg.

Nga AUV-I ka ardh një kërkesë për inspektimin e subjekteve afariste ushqimore për pranin e çamqakezave te firmës TWIST te cilat janë me afat të dyshimtë te përdorimit, gjate inspektimit nuk është gjetur produkti i tillë në treg aksioni i inspektimit ende është duke vazhduar për këtë produkt.

Në thertore janë inspektuar kafshët për therrje.

Gjatë muajit mars janë inspektuar disa fshatra në bazë të kërkesave të palëve dhe planit tonë, me ç’rast janë dhënë vërejtje, urdhëresa me procesverbal për sanimin e parregullsive, kërkesat kishin të bëjnë me plehrat e kafshëve, ujerat e zeza dhe mbeturinat.

Janë inspektuar vendgrumbullimet ilegale të mbeturinave në qytet dhe rrethinë, me ç’rast janë bërë dy gjoba mandatore për hedhje të mbeturinave në natyrë, dhe për shkak të mos pagesës së tyre lëndët janë dërguar për në gjykatë.

Këtë muaj si grup punues i komisionit kemi lëshuar tri Leje Mjedisore Komunale dhe gjithashtu kem punuar edhe rreth shqyrtimit të disa kërkesave tjera për LMK .

Janë inspektuar mishtoret në lidhje me hedhjen e eshrave, ku me procesverbal janë urdhëruar që të bëjnë kontratë të veçantë me kompaninë përkatëse për dorëzimin e këtyre eshrave.

Në muajin Mars është bërë inspektimi-kontrollimi i kompanive të autobusëve dhe auto-taksit, janë kontrolluar edhe parkingjet e auto-taksive në rrugët e qytetit se mos po hasim ndonjë duke ushtruar veprimtari ilegale, po ashtu edhe në Aeroportin Ndërkombëtar “ Adem Jashari “ në Vrellë në bashkëpunim me policin kufitare, kemi inspektuar edhe kompanitë e autobusëve në udhëkryqin për Gadime-Llugagji dhe në Babush kemi bërë edhe inspektimin e tregjeve si tregu i gjelbër, kafshëve dhe i mobileve.

Në lëmin e ndërtimit janë inspektuar të gjitha objektet ndërtimore të cilat janë duke u ndërtuar.

Gjatë këtij muaji janë inspektuar marketet ushqimore për produkte me prejardhje bimore. Gjithashtu janë inspektuar të gjithë shitësit dhe tregtuesit e plehrave artificiale që operojnë në Komunën tonë, po ashtu janë inspektuar Tokat Bujqësore të cilat kanë filluar të mbushen me materiale të ndryshme si dhe atyre që po u ndërrohet destinimi. Kemi pasur disa aksione me inspektorët e ndërtimit rreth ndërtimeve pa leje dhe ndërrim destinimin e tokave.

Tokat Bujqësore që janë mbushur me dhe e që posedojnë pëlqime Komunale janë urdhëruar ta bëj rrafshimin dhe nivelizimin e tyre sipas standardeve të kërkuara në ligjin për tokat bujqësore, janë inspektuar edhe disa Bletishte me kërkesë të palëve për regjistrimin e tyre dhe aplikime në subvencionet 2017.

Për të gjitha parregullsitë është dhënë urdhër me procesverbale për evitimin e tyre, për çdo shkelje është vepruar konform ligjeve në fuqi.